

AKT - MAREVESHJE

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË TREGËTARE

PRIVATE E EMËRTUAR "PATKOJA" SH.P.K.

Set, më dt. 12.5.1994, në Shkodër, formohet shoqëria private me përgjegjësi të kufizuar, e përbërë nga ortakët:

1. NAIM PATKOJA, i biri i Aliut, i dt.lindjes 1954, lindur dhe banor në Shkodër, Lagjia Vojo Kushi, Rr.Çlirimi Pall.1261

2. ENGJELL RADONINA?, i biri i Zefit, i dt.lindjes 1958, lindur dhe banor në Shkodër, Lagjia Qemal Stafa, Rr.Vojo Kushi, Pall.27, të dy me zotësi të plote juridike për të vepruar, të cilët bëjnë këtë akt mareshje, që shërben si akt themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, e emërtuar "PATKOJA"

Neni 1

Widit të lartpërmendurëve, u ra dakort që të krijohet shoqëria private me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.)

EMËRTIMI : Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e vet me emrin "PATKOJA".

KOHËZGJATJA : Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë mbi 10 vjetë, dhe ke filluar ky afat nga dita e regjistrimit të shoqërisë si person juridik

VENDI ku do të ushtrohet aktiviteti: Në të gjithë territorin e Shqipërisë, me qendër në Shkodër.

SELIA juridike e shoqërisë do të jetë në Shkodër, Rr.Çlirimi Pal 1261.

KAPITALI : Kapitali fillestar për vënien në efikasitet të veprimit të së shoqërisë është në shumën 100.000 lekë, e ndarë në mënyrë proporcionale nga ortakët në masën 50% secili. Për depozitimin e shumës së më sipër është mbajtur një proces verbal nga ortakët dhe që do të bashkëngjitet dokumentave të shoqërisë.

VULA e shoqërisë do të jetë e rrumbullëkët, me madhësi mesatare mbi të cilën është shkrojtur: Shoqëria "PATKOJA" SH.P.K. Shkodër Alban

Neni 2

OBJEKTI

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë në fushën e : -Ndërtimit të objekteve sociale, industriale, turistike, bujqësore

- Vepra beton arme te vegante (ura ,rrugë, shtrim rrugësh)
- Punime hidraulike (ujësullës dhe kanalizime)
- Prodhimi dhe tregtimi i lëndës drusore , tregtimi i materialeve te ndërtimit.

Neni 3

Të ardhurat e realizuara nga ortakët do të ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre , në masën 50% te fitimit secili, dhe ky veprim do të pasqyrohet me proces verbal.

Neni 4

Drejtor egzekutiv i shoqërisë do të jetë NAIM FATKOJA, i cili nga ky moment merr atributet e drejtuesi të shoqërisë dhe Z/drejtor do të jetë ortaku Engjell Redohina , i cili do të jetë gjithashtu dhe administrator i shoqërisë.

Neni 5

Përfaqsimi i shoqërisë në marrëdhënie me personat fizikë, juridikë etj. do të bëhet nga Drejtori egzekutiv i shoqërisë . Në mungesë të tij këtë detyrë e kryen Z/Drejtori i shoqërisë , i cili nëvëndoson titullarin e shoqërisë. Drejtori egzekutiv i shoqërisë , për nevoja pune , ka të drejtë të caktoj si përfaqësues dhe persona te tjere , pasi i pajis me prokurë të posaçme.

Neni 6

Organet drejtuese te shoqërisë janë:

- Asambleje e ortakëve
- Këshilli administrativ
- Këshilli sindikal.

Mënyret e emërimit dhe funksionimit të tyre përcaktohen nga Statuti.

Neni 7

Shoqëria ka të drejtë të marrë në punë puntorë , te cilët sipas ligjit "mbi marrëdhëniet e punës" do të përpilojnë kontrata te vegante pune, në të cilat parashikohen kushtet e punës, kohëzgjatja, pagesa ditore, kohë e pushimit ditor, javor dhe vjetor, marrëdhëniet me sigurimet shoqërore, etj. Mosmarrveshjet e punëtorëve me shoqërinë do të zgjidhen nga gjykata.

Neni 8

Ortakët mund të prishin shoqërinë mbasi të kenë shlyer të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga veprimet e shoqërisë.

Neni 9

Mosmarrveshjet e krijuara brënda shoqërisë si dhe ato me personat

fizikë ose juridikë, vëndas apo të huaj duhet të zgjidhen me mirkuptim, në të kundërt palët mund t'i drejtohen gjykatës së Rrethit Tiranë.

Artikulli 10

E gjithë veprimetris e shoqërisë është e mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga organet kompetente. Si bazë në këtë drejtim shërbejnë dhe aktet e shoqërisë sipë Statuti i miratuar si dhe akti i themelimit të shoqërisë.

Kjo akt marrveshje përpilohet në katër kopje, nga të cilat njëra dorzohet në Gjykatën e rrethit, ku bëhet regjistrimi si person juridik, një tjetër në Zyrën e Noterisë, një në zyrën e financës dhe një ruhet në dokumentacionin e shoqërisë.

ARTAKËT THEMELUES

NAIM FATKOJA

ENGJELL RADOMINA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA TIRANË

Nr. 6608/Rep.
Nr. 3504/Kol.

VËRTETIM

Sot, më dt. 5.1994, në Zyrën e Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht Naim Fatkoja dhe Engjell Radomina, me zotësi procedurjale për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova nga letër njoftimet që më paraqitën, të cilët deklaruan se se më sipër, është një akt marrveshje përpiluar jashtë kësaj zyre, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të cilët e nënshkruan përpara meje Noteres dhe unë Noterje e vërtetojë sipas ligjë.



NOTERJE
Luizide Selami

S T A T U T I

PER VEPRIMTARINE EKONOMIKE TE SHOQERISE ME

PERGJESJESI TE KUFIZUAR

"PATKOJA"

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Shoqëria tregëtare private "PATKOJA" SH.P.K. krijehet nga ortakët NAIM PATKOJA dhe ENOJELL RADONINA, në bazë të kriterëve të përcaktuara në ligjin 7512 dt. 10.8.1991, 7632 dt. 4.11.1992 dhe 7638 dt. 19.11.1992

Neni 2

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë.

Neni 3

Ortakët në këtë sipërmarrje kanë derdhur kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që do të vijnë nga veprimtaria private e shoqërisë së dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të kapitalit themeltar.

Neni 4

Shoqëria "PATKOJA" është person juridik dhe fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin në Gjykatën e rrethit Tiranë dhe pajisjes me lejen e ushtrimit të veprimtarisë nga Zyra e Tatimeve të rrethit Shkodër.

Neni 5

Emërtimi i shoqërisë do të jetë : Shoqëria tregëtare private "PATKOJA" SH.P.K. Shkodër.

Neni 6

Selia e shoqërisë do të jetë: Pr. Çlirim Pell. 1261 -Shkodër.


Neni 7

Aktiviteti i shoqërisë do të jetë mbi 10 vjetë.

Neni 8

Shoqërija do të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë terri torin e Shqipërisë.

Ajo mund të krijojë degë apo përfaqsi dhe në rrethe të tjera të vendit.



Neni 9

OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

-Ndërtimi i objekteve sociale, industriale, turistike, bujqësore, punime restaurimi.

-Vepra beton arme te veganta (ura, rrugë, shtrim rrugësh)

-Punime hidraulike (ujshjellës dhe kanalizime)

-Prodhimi dhe tregëtimi i lëndës drusore , tregëtimi i materialeve te ndertimit.

Neni 10

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregëtare private "PATKOJA" është plotësisht kapital vendas dhe është investuar nga ortakër Naim PATKOJA dhe Engjell RADONINA. Kapitali themeltar arrin vleften 100.000 lekë dhe përbehet nga kontributi i ortakëve ne masen 50% secili.

Neni 11

Kapitali themeltar mund te rritet me shtimin e aktivitetit te shoqërisë . Zvogëlimi i kapitalit themeltar nen vleften 100.000 lekë e detyro shoqërine të shndërrohet në një formë tjetër , në rast se ajo nuk merr vendim për rritjen e kapitalit deri në vleften e mësipërme.

Neni 12

Me pëlqimin e ortakëve themelues , pjesë të kapitalit themeltar ja ne te transferueshme , në rrugë trashëgimije, ose personave te tjerë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri. Transferimet e kapitalit vertetohen me akt noterial.

Neni 13

FONDET E SHOQËRISË

Shoqëria përcakton fondet e mëposhtëme:

-Fondi qarkullues (themelor)

-Fondi rezervë

-Fonde te tjera të cilat mund te jenë te nevojshme gjatë veprimtarisë së shoqërisë.

Masa e secilit fond rezerve dhe mënyra e përdorimit të tij përcaktohet me vendim te organit drejtues të shoqërisë.

Neni 14

Organi më i lartë administrativ i shoqërisë është Asambleja e ortakëve, që ka te drejtë te vendose për çdo çështje që i përket shoqërisë.

Neni 15

Për çdo mbledhje të asamblese së ortakëve , ortakët do të njoftohen 15 ditë më përpara , me leter rekomande. Letra duhet të mbajë datën, kohën dhe vendin dhe qëllimin e mbledhjes.

Neni 16

Shoqëria tregëtare private "PATKOJA" do të ketë si drejtor egzekutiv Z. Neim Patkoja, Z/drejtor egzekutiv dhe administrator do të jetë Z. Engjell Radohina.

Neni 17

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË ORTAKËVE

Asambleja e ortakëve vendos për ndryshimet e Statutit dhe mirëton rregulloren e sektoreve të veçante.

Ajo vendos për politikën efariste të shoqërisë dhe përcakton fuqitë konkrete të veprimtarisë së shoqërisë .

Asambleja e ortakëve zgjedh dhe shkarkon Drejtorin egzekutiv të shoqërisë.

Asambleja shqyrton bilancin vjetor, kuotat , fondet rezerve, fondet e ndryshme dhe fitimin e realizuar.

Neni 18

Asambleja ka të drejtë të emërojë dhe shkarkojë administratorët e shoqërisë , vendos për marrjen e kredive dhe pushimin e shoqërisë ose për shndërrimin e shoqërisë në një formë tjetër.

Neni 19

Asambleja mirëton dhe realizon marrëditjet e shoqërisë me persona të tjerë fizikë dhe juridike si dhe vendos për pagat e punonjësve.

Neni 20

Asambleja emëron një ose disa ekspertë kontabël për të shqyrtuar bilancin vjetor si dhe të gjitha rezultatet , të ardhurat e qarkulluara mënyrën e mbajtjes së regjistrit tregëtar dhe të veprimeve kontabile.

Neni 21

KOMPETENCAT E DREJTORIT EGZEKUTIV

Kompetencat e drejtorit egzekutiv do të jenë:

-Ka të drejtë të depozitojë firmën e tij në bankën ku shoqëria ka llogarinë rrjedhese të saj.

-Ka të drejtën e nënshkrimit të kontratave që lidh shoqëria.

-Drejtori egzekutiv e përfaqëson shoqërinë në të gjitha marrëditjet juridike . Ai ka të drejtë të japë prokurë personave të tjerë që të bëjnë

përfaqsimet për shoqëritë gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj.

Neni 22

Ortakët kanë të drejtë të vendosin, nëpërmjet mbledhjes së Asamblesë për ndarjen e fitimeve dhe të humbjeve, shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shtetërore, personave fizikë ose juridike, vendas ose të huaj.

Neni 23

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtë dhe detyrë organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së shoqërisë. Në marrëdhënie me të tretet, administratori e angazhon shoqëritë nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 24

Administratori ka të drejtë të njihet me veprimtarinë si dhe me dokumentacionin, llogarite përkatëse, në rast se keto mbahen nga personat tjerë të ngarkuar prej tij.

Neni 25

Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e përditëshme dhe kërkon shpjegime, raportime për çdo problem dhe nga çdo punonjës që i ka kryer.

Ka të drejtën e vlerësimit dhe të marrjes së masave disiplinore deri në largim nga puna të punonjësve dhe zgjidhjen e kontratës së punës me ta.

Neni 26

NDARJA E FITIMIT

Ndarja e fitimit bëhet pas përbëllimit të detyrimeve, taksave, taksimeve, pra mbasi mbetet në dispozicion vetëm fitimi netto.

Neni 27

Fitimi netto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit, për shtimin e kapitalit themelues në kapital në natyrë, ose ndahet sipas kontributit të vënë nga ortakët në kapitalin themelues.

Neni 28

MARRËDHËNIJET FINANCIARE TË SHOQËRISË

Shoqëria "PATKOJA" SH.P.K. mund të lidhë kontrata me sektore shtetërore d.p. d. në tregun e lirë, si dhe me persona fizikë ose juridike vendas ose të huaj.

Neni 29

Në veprimet kontraktuale shoqëria përfaqësohet nga drejtori egzekutiv

kutiv Naim Fatkoja , ose nga Z/drejtori egzekutiv dhe administratori Engjell Radohina. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga keto kontrat janë të detyrueshme për shoqërinë.

Neni 30

Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqerore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likuiduese pranë bankave dhe të kryejë veprimet nëpërmjet tyre. Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike , shoqëria ka të drejtë të vetë financohet në lekë ose në valutë të huaj. Shkëmbimi i monedhës mund të bëhet nga Banka e shtetit ose në tregun e lirë privat të valutës.

Neni 31

Për pasqyrimin e aktivitetit privat, administratori ose persona të tjerë të caktuar prej tij , janë të detyruar të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar dhe regjistrat përkatës.

Neni 32

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë, mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Administratori ose personat e ngarkuar prej tij, janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklaratën e të ardhurave dhe të depozitave në organin financiar të juridiksionit përkatës.

Neni 33

MARDHËNIJET E PUNËSIMIT

Çdo person i punësuar në shoqëri quhet si i tillë në bazë të një kontrate pune që lidhet midis tij dhe drejtorit egzekutiv të shoqërisë , në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo person i punësuar në shoqëri , është personalisht përgjegjës për punën e tij;

Neni 34

Punonjësi është i detyruar të ruaj sekretin dhe karakterin e fshehtë të dokumentacioneve, të përmbashe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës dhe vendimet e marra nga shoqëria.

Neni 35

Marrja në punë bëhet me regjistrimin nga punëdhënësi në librin e punës të shoqërisë si dhe duke njoftuar organet e punësimit të juridiksionit ku ushtron aktivitetin shoqërisë.

Neni 36

Largimi nga puna bëhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me vete kërkesën e të interesuarit/Punonjësi largohet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga administratori. Largimi nga shoqëria bëhet pasi të jenë shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

Neni 37

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, detyrimeve të tjera ndaj shtetit sigurimeve shoqerore, të ardhurat kalojne në pronësi të dy ortakëve.

Neni 38

Te ardhurat nga veprimtaria private e shoqërisë do të sigurohen sipas qmiveve që siguron vetë shoqëria .

Çmimet dhe tarifet caktohen sipas kërkesës dhe ofertës.

Neni 39

MBARIMI I SHOQËRISE

Veprimtaria e shoqërisë mbaron me vendim të organit të saj të brejtues ne rast se aktiviteti i saj nuk rezulton fitimprurës, për shkak të forcës madhore si dhe për shkaqe të tjera ligjore.

Shoqëria mund të mbaroje dhe me anë të riorganizimit dhe nëpërmjet formave të thithjes dhe të bashkimit.

Neni 40

Në rast se kapiteli i shoqërisë, për shkak të humbjeve , arrin se gjyke me e kapitalit fillester , ortakët mund të kërkojnë në gjykatë prishjen e shoqërisë . Gjykata mund të ofrojë shoqërisë një afat maksimal prej 6 muajsh për të rregulluar gjëndjen .

Neni 41

Mosmarveshjet e krijuara brënda shoqërisë si dhe ato ndërmjet saj dhe personave fizike dhe juridike , vëndes dhe të huaj, duhet të zgjidhen me mirëkuptim , në të kundërt palet duhet të drejtohen Gjykatës së rrethit .

Neni 42

DISPOZITA TË FUNDIT

Viti financiar i shoqërisë fillon në 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor. Pasurija e shoqërisë mund të sigurohet në institutin e sigurimeve shoqerore.

Neni 43

Për se bëhtë shprehur në këtë Statut i referohet Ligjit 7512 dt. 10.8.1991, 7632 dt.4.11.1992 dhe 7638 dt. 19.11.1992, dhe çdo akti tjetër të legjislacionit shqiptar.

Neni 44

Statuti përpilohet ne disa kopje për tju dorëzuar organeve kompetente.

Ky Statut u hartua sot më dt. 12.5.1994.

